

<b>RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	
<b>EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS</b>	Projektligji “Për regjistrin e Pronarëve Përfitues”.
<b>MINISTRIA UDHËHEQËSE</b>	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
<b>FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	Zhvillim
<b>BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS</b>	Direktive e BE
<b>DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së</b>	Jo e zbatueshme
<b>PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA</b>	Jo e zbatueshme
<b>DATA E KONSULTIMIT PUBLIK</b>	Data/Asnjë konsultim publik
<b>DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	Data e vlerësimit të ndikimit
<b>A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT</b>	Jo Data e shqyrtimit
<b>NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	2020-MFE-
<b>TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)</b>	Enhela Shehu <a href="mailto:Enhela.shehu@qkb.gov.al">Enhela.shehu@qkb.gov.al</a>

### **PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (maksimumi 2 faqe)**

#### **PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT**

*Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Jepni arsyet e nevojës së ndërhyrjes së qeverisë. (jo më shumë se 10 rreshta)*

Mundësinë e popullimit automatik të regjistrimit të pronarëve përfitues nga Qendra Kombëtare e Biznesit për subjektet raportuese që kanë pronësi direkte, duke ju referuar gjendjes së ortakërisë të regjistruar në regjistrin tregtar për subjektet raportuese me pronësi direkte, me qëllim reflektimin e rekomandimeve të MONEYËAL për Shqipërinë.

#### **OBJEKTIVAT**

*Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit? (jo më shumë se 7 rreshta)*

- popullimin automatik të regjistrimit të pronarëve përfitues nga Qendra Kombëtare e Biznesit për subjektet raportuese që kanë pronësi direkte, duke ju referuar gjendjes së ortakërisë të regjistruar në regjistrin tregtar për subjektet raportuese me pronësi direkte.
- shtyrjen e afatit për raportimin fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese që regjistrohen rishtazi, nga brenda 30 ditëve kalendarike nga data e regjistrimit të subjekteve raportuese, në brenda 40 ditëve kalendarike nga data e regjistrimit të subjekteve raportuese.
- faljen e gjobave të vendosura nga QKB-ja përpara hyrjes në fuqi të projektligjit, në lidhje me mos përmbushjen e detyrimit për raportimin fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese, pa i çliruar nga detyrimi që raportimi të kryhet prej tyre deri më datë 01.04.2022.

- përshkallëzimin e masës së kundërvajtjeve administrative që do të vendosen në vijim të hyrjes në fuqi të projektligjit, mbi bazën e vonesës në përmbushjen e detyrimit të raportimit fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese që regjistrohen rishtazi.
- parashikimin e procedurës së pezullimit të aplikimit për një afat 30 ditor, në rast të aplikimeve të paplota.
- heqjen e gjobës për administratorin në rastin e mosregjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues të subjekteve raportuese brenda afatit ligjor, dhe përfshirja e vlerës së kësaj gjobe në gjobat e vendosura ndaj subjekteve raportuese.
- lejimi i ofrimit të shërbimit të ndryshimit/riemërimit të administratorit ose të përfaqësuesit ligjor të subjekteve raportuese në rastet kur ndaj subjekteve raportuese është vendosur gjobë dhe është ndërprerë shërbimi në regjistrin tregtar dhe në Regjistrin e Organizatave JoFitimprurëse.

### **OPSIONET E POLITIKAVE**

*Cilat janë opsionet kryesore të politikave? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. (jo më shumë se 7 rreshta)*

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

Opsioni 0: – status quo-ja;

Opsioni 1- ligj i ri;

Opsioni 2: – ndryshimi i legjislacionit ekzistues /arritja e objektivave duke nderhyrë në aktet nënligjore

### **ANALIZA E NDIKIMEVE**

*Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përshkruajë ndikimet në mënyrë sasiore (monetare) dhe cilësore (narrative) mbi buxhetin dhe grupet e tjera të prekura. (jo më shumë se 10 rreshta)*

**Opsioni i preferuar është opsioni nr.2.**

Lidhur me ndikimet në vlerë monetare të përcaktuara, ky ndryshim parashikon popullimin automatik të regjistrit të pronarëve përfitues nga Qendra Kombëtare e Biznesit për subjektet raportuese që kanë pronësi direkte, duke ju referuar gjendjes së ortakërisë të regjistruar në regjistrin tregtar për subjektet raportuese me pronësi direkte.

Lidhur me ndikimet që ky projektligj do të ketë tek bizneset, vlerësohet se ndryshimet nuk ka asnjë ndikim pasi detyrimi për të regjistruar është miratuar me ligji që po ndryshojme.

### **ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR**

*Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (jo më shumë se 7 rreshta)*

**Opsioni i preferuar është opsioni nr.2.**

Ndryshimet nuk shtojnë kosto për buxhetin e shtetit pasi regjistri aktualisht është krijuar dhe popullimi do behet automatikisht nga sistemi.

**Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):**

<b>Viti 1</b>	<b>Viti 2</b>	<b>Viti 3</b>
0	0	0
<p><b>KONSULTIMI</b>  <i>Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar? (jo më shumë se 5 rreshta)</i>  <i>do te plotesohet ne nje moment te dyte pasi drafti te jete miratuar nga KM dhe te hidhet per konsultim public</i>  <i>Nuk aplikohet</i></p>		
<p><b>ZBATIMI DHE MONITORIMI</b>  <i>Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?(jo më shumë se 5 rreshta)</i></p> <p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Qendra Kombëtare e Biznesit dhe institucionet e tjera përgjegjëse, si dhe subjektet raportuese dhe subjektet e detyruara për marrjen e masave për zbatimin e këtij projektligji.</p> <p>Për zbatimin dhe monitorimin e këtij projektligji janë parashikuar nxjerrja e akteve nënligjore.</p>		

## **PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE**

### **Historik**

*Jepni kontekstin e politikës.*

Deri më sot, bazuar në Ligjin Nr. 9917/2008 “Per Parandalimin e Pastrimit te Parave dhe Financimit te terrorizmit”, i ndryshuar, subjektet e detyruara sipas këtij ligji kishin detyrimin të identifikonin vetë pronarët përfitues të klientëve të tyre. Megjithatë, të dhënat e pronarëve përfitues të identifikuar nga këto subjekte të detyruara nuk kanë qënë të regjistruar në një regjistër kombëtar të posacem.

Gjithashtu, subjektet e regjistruara në Republikën e Shqipërisë, bazuar në legjislacionin aktual, nuk kanë detyrimin të identifikojnë dhe të rregjistrojnë në një regjister të posacem kombëtar të dhenat për pronarët e tyre përfitues.

### **Problemi në shqyrtim**

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Me miratimin e ligjit nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, i ndryshuar, të gjitha subjektet raportuese të regjistruara në Republikën e Shqipërisë kanë detyrimin e regjistrimit të pronarëve përfitues në Regjistrin e Pronarëve Përfitues. Gjithashtu, ky ligj parashikoi se subjektet raportuese ekzistuese duhet të regjistrojnë të dhënat e pronarëve të tyre përfitues deri më datë 30.06.2021 (afat i shtyrë me anë të Aktit Normativ nr.12, datë 25.03.2021, miratuar me ligjin nr.55/2021). Ndërkohë, që bazuar në këtë ligj subjektet raportuese të krijuara rishtazi kanë detyrimin të regjistrojnë pronarët e tyre përfitues brenda 30 ditëve kalendarike nga data e regjistrimit të subjekteve raportuese, në rastin e regjistrimit fillestar të pronarëve përfitues.

Megjithatë, nga analizimi i të dhënave të regjistruara në Regjistrin e Pronarëve Përfitues, rezulton se nga 59165 subjekte raportuese ekzistuese të regjistruara në Regjistrin Tregtar përpara datës së krijimit të

Regjistrin të Pronarëve Përfitues, prej të cilëve 8689 subjekte me statusin pezulluar, bazuar në VKM nr.273/2021 kanë detyrimin të regjistrojnë pronarin përfitues në regjistrin e pronarit përfitues, përpara kërkesës për ndryshimin e statusit të tyre në regjistrin tregtar, vetëm 21460 subjekte raportuese ekzistuese kanë regjistruar të dhënat e pronarëve të tyre përfitues në regjistër deri më datë 10.11.2021.

Gjithashtu, nga 4861 Organizata Jofitimprurëse ekzistuese të regjistruara në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse, vetëm 1961 Organizata Jofitimprurëse kanë regjistruar të dhënat e pronarëve të tyre përfitues në regjistër.

Ndërkohë, nga analiza e bërë rezultoi se nga 2869 subjekte raportuese të krijuara rishtazi pas krijimit të Regjistrin të Pronarëve Përfitues (gjatë periudhës kohore 01.02.2021-10.11.2021), vetëm 1972 subjekte kanë regjistruar të dhënat e pronarëve të tyre përfitues në regjistër brenda 30 ditëve kalendarike nga data e regjistrimit të tyre në regjistrin tregtar.

Me qëllim rregullimin e kësaj situatë dhe zbatimin e rekomandimeve të ekspertëve të MONEYVAL, të cilët kërkojnë që Shqipëria të krijojë mekanizma që të sigurojnë një numër sa më të lartë të subjekteve raportuese që regjistrojnë të dhënat e pronarëve të tyre përfitues, u vlerësua ndërmarrja e disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin ekzistues nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, i ndryshuar.

### **Arsyeja e ndërhyrjes**

- *Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Qeveria planifikon të ndërhyjë me qëllim popullimin automatik të regjistrin të pronarëve përfitues nga Qendra Kombëtare e Biznesit për subjektet raportuese që kanë pronësi direkte, duke ju referuar gjendjes së ortakërisë të regjistruar në regjistrin tregtar për subjektet raportuese me pronësi direkte me qëllim zbatimin e rekomandimeve të Komitetit të Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL) të Këshillit të Europës, Kryeministri ngriti grupin ndërinstitucional të punës për zbatimin e rekomandimeve të MONEYVAL. .

### **Objektivi i politikës**

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

- Objektivat kryesore që synohen të arrihen nëpërmjet kësaj politike janë: - popullimin automatik të regjistrin të pronarëve përfitues nga Qendra Kombëtare e Biznesit për subjektet raportuese që kanë pronësi direkte, duke ju referuar gjendjes së ortakërisë të regjistruar në regjistrin tregtar për subjektet raportuese me pronësi direkte. shtyrjen e afatit për raportimin fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese që regjistrohen rishtazi, nga brenda 30 ditëve kalendarike nga data e regjistrimit të subjekteve raportuese, në brenda 40 ditëve kalendarike nga data e regjistrimit të subjekteve raportuese. faljen e gjobave të vendosura nga QKB-ja përpara hyrjes në fuqi të projektligjit, në lidhje me mos përmbushjen e detyrimit për raportimin fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese, pa i çliruar nga detyrimi që raportimi të kryhet prej tyre deri më datë 01.04.2022. përshkallëzimin e masës së kundërvajtjeve administrative që do të vendosen në vijim të hyrjes në fuqi të projektligjit, mbi bazën e vonës në përmbushjen e detyrimit të raportimit fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese që regjistrohen rishtazi. parashikimin e procedurës së pezullimit të aplikimit për një afat 30 ditor, në rast të aplikimeve të paplota. heqjen e gjobës për administratorin në rastin e mosregjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues të subjekteve raportuese brenda afatit ligjor, dhe përfshirja e vlerës së kësaj gjobe në gjobat e vendosura ndaj subjekteve raportuese. lejimi i ofrimit të shërbimit të ndryshimit/riemërimit të administratorit ose të përfaqësuesit ligjor të

subjekteve raportuese në rastet kur ndaj subjekteve raportuese është vendosur gjobë dhe është ndërprerë shërbimi në regjistrin tregtar.

### **Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara**

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.*

Gjatë analizës që është kryer, janë shqyrtuar tre opsionet e mëposhtme: **Opsioni 0 (status quo):** Kuadri ligjor ekzistues nuk parashikon detyrimin ligjor të subjekteve të regjistruara në Republikën e Shqipërisë për identifikimin dhe regjistrimin e të dhënave të pronarëve të tyre përfitues. **Opsioni 1:** Hartimi i një ligji të ri për metrologjinë Hartimi nuk bene te mundur popullimin **Opsioni 2:** Ndryshimi i ligjit ekzistues eshte e vetmja alternativ.

### **Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve**

- *Identifikoni grupet e prekura.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
  - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
  - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
  - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).*
  - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
  - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
  - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
  - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
  - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
  - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
  - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
  - *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).*

Ndikimi është i drejtpërdrejtë, është tek subjektet raportuese te regjistruara në Republikën e Shqipërisë, të cilat do të kenë detyrimin ligjor të identifikojnë dhe regjistrojnë në një regjistër kombëtar të posacem pronarët e tyre përfitues. Gjithashtu, edhe Autoritetet kompetente shtetërore dhe subjektet e detyruara që i nënshtrohen ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit do të preken dpd nga ky ligj pasi do të kenë detyrimin të raportojnë çdo mospërputhje mes të dhënave të regjistruara në regjistër dhe të dhënave qe ato zotërojnë për pronarët përfitues të subjekteve raportuese. Ndikimi social: Transparenca në fushën e pronarëve përfitues, dhe mundësimi i marrjes së informacionit nga cdo person që paraqet interes të ligjshëm që të marrë informacion lidhur me pronarët përfitues të subketeve të raportuese..

## **Arsyetimi i opsionit të preferuar**

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni i preferuar është Opsioni 2: Pasi menyra e popullimit e vendosur me ligj mund të ndyshojë në të njëjten mënyrë si u miratuar e cila do të përmbushë më mirë rekomandimet e MONEYVAL dhe objektivat e vendosura..

## **Çështje të zbatimit**

- *Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*

Ministria e Financave dhe Ekonomisë është përgjegjëse për koordinimin dhe monitorimin e zbatueshmërisë së ligjit, pas miratimit të këtij propozimi, nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe institucionet e tjera përgjegjëse.

Përkatësisht:

1. Qendra Kombëtare e Biznesit e cila do të jetë përgjegjëse:
  - a. të regjistrojë, administrojë, përpunojë dhe ruajë në regjistër të dhënat e deklaruara nga subjektet raportuese;
  - b. të mundësojë disponueshmërinë e të dhënave të Regjistrit, në përputhje me këtë ligj;
  - c. të lëshojë ekstrakte për të dhënat e regjistruara në regjistër;
  - d. të ndërmarrë veprime të tjera në përputhje me këtë ligj.
2. AKSHI, i cili do të jetë përgjegjës për popullimin automatik të Regjistrit të Pronarëve Përfitues.
3. Autoritetet kompetente shtetërore, do të kenë akses elektronik të lirë, direkt dhe të pakufizuar në të dhënat e regjistruara në regjistër, në funksion të përmbushjes së detyrave të tyre ligjore që lidhen me inspektimin e Regjistrit të Pronarëve Përfitues dhe mbledhjen e të dhënave mbi pronarët përfitues.
4. Subjektet e detyruara mund të marrin informacion për të dhënat e regjistruara në regjistër, të cilat nuk janë lirisht të aksesueshme dhe publike, kur këto të dhëna nevojiten për përmbushjen e detyrave të tyre ligjore.

Për zbatimin e ligjit dhe përputhshmërinë me kërkesat e tij do të ndërmerren hapat e mëposhtme:

- o Do të hartohen dhe miratohen aktet nënligjore përkatëse

## **Faza e monitorimit dhe vlerësimit**

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre.*

Indikatorët për të matur arritjen e objektivave janë si më poshtë:

- a) numri i subjekteve raportuese ekzistuese që kanë regjistruar brenda afatit kohor ligjor të dhënat e pronarëve të tyre përfitues

b) numri i subjekteve raportuese që kanë regjistruar brenda afatit kohor ligjor të dhënat e pronarëve të tyre përfitues, në vazhdim

c) numri i rasteve të njoftuara nga Autoritetet kompetente shtetërore dhe subjektet e detyruara për mospërputhshmëri mes të dhënave të regjistruara në regjistër dhe të dhënave që ato zotërojnë për pronarët përfitues të subjekteve raportuese

d) numri i gjobave të vendosura për mosplotësimin e detyrimeve ligjore të përcaktuara në këtë ligj..

#### **Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a**

*Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuara në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.*

#### **Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b**

*Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni*

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	0	0	0
Opsioni 2	0	0	0

**MINISTËR**

[Emri Mbiemri]